



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:112205

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05591438

AC-I-24-0174

Në ankesën e

Paditësi/ankuesi

Xh S B, I përfaqësuar nga avokat I H nga Gjakova.

Kundër

Të paditurit

M Tdhe K T.- të përfaqësuar nga avokat M B.

Ndërhyrës në Procedurë,

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. " Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë,
Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-III-24-0019 të datës 23 shkurt 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 prill 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktvendimi i Shkallës së I-re i DHPGJS C-III-24-0019 i datës 23 shkurt 2024.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Më 01 qershor 2022, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, paditësi Xh B ka paraqitur padi për kompensim dëmi, kundër të pandehurve M dhe K T, me propozim për masë sigurimi. Në padi dhe propozimi për masë sigurimi, ndër të tjera ka theksuar: paditësi është bashkëpronar i paluajtshmerisë-Parcelë Kadastrale, P-...., që gjendet në Zonën Kadastrale Prishtinë, vendi i quajtur J. Të paditurit kanë qenë në posedim të pronës kontestuese që nga koha kur paditësi e ka fituar të drejtën e tij pronësore. Paditësi me padi ka propozuar që gjykata të marrë aktgjykim me të cilin do të detyrojë të paditurin që t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar, në lartësinë që do të përcaktohet përmes ekspertizës. Me datën 06 dhjetor 2024, paditësi ka bërë korrigjimin e padisë, ku ka kërkuar që të detyrohen të paditurit që t'ia dorëzojnë në posedim paluajtshmerinë - NK ..(në vazhdim: prona kontestuese), si dhe t'ia kompensojnë dëmin e shkaktuar për shkak të shfrytëzimit të pa autorizuar të saj.

Me 10 shkurt 2023 e Gjykatës themelore në Prishtinë, me aktvendimin C.nr.2646/22, AKP-së i ka pranuar cilësia e ndërhyrësit në procedurë, në anën e të paditurve, është shpallur jo kompetente për gjykimin në këtë çështje kontestimore dhe lëndën e ka dërguar në kompetencë të mëtejshëm në Dhomën e Posaçme përmes aktit përcjellës. Propozuesi i sigurimit, bashkë me padinë dhe propozimin për masë sigurimi, ka dorëzuar provat si në vijim: Certifikata pronësore nr..., të datës .. dhjetor.., që i referohet parcelës kadastrale...

Më 09 shkurt 2024, AKP-ja si ndërhyrëse në procedurë, ka paraqitur përgjigje në kërkesën për masën e sigurimit, ku ndër të tjera ka theksuar: Edhe pse formalisht paditësi evidentohet si pronar i pronës kontestuese, pronare është N.SH "Bujqësia", me seli në Fushë Kosovë. Lidhur me pronën kontestuese, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, paditësi është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale-Krim i Organizuar nga neni 274.3 i KPK-së dhe Aktgjykimi është bërë i formës së prerë. Për këto arsye, AKP-ja ka ushtruar padi në Dhomën e Posaçme për anulimin e kontratave të shitjes, andaj paditësi nuk gëzon asnjë të drejtë në pronën kontestuese. Ka propozuar që të refuzohet propozimi për masë sigurimi. Kundërshtimit nuk i është bashkangjitur ndonjë provë.

Më 13 shkurt 2024, kundërshtaret e sigurimit kanë paraqitur kundërshtimin në propozimin për masë sigurimi, ku ndër të tjera kanë theksuar:prona kontestuese, sipas fletës poseduese nr... ishte pronë shoqërore në emër të KBI "Kosova Export"- N.SH "Bujqësia" . Të paditurit kanë lidhur kontratë të qirasë me N.SH "Bujqësia", për shfrytëzimin e të njëjtës pronë për një periudhë prej 10 vitesh, respektivisht deri më 01 qershor 2012. Të njëjtës pronë i është hequr statusi i pronës shoqërore duke u mbështetur në vendime gjyqësore dhe kontrata të shitblerjes të falsifikuara, lidhur me të cilat është zhvilluar procedurë penale. Kanë propozuar që të refuzohet propozimi për caktimin e masës së sigurimit. Përgjigjes në propozimin për masë sigurimi i kanë bashkangjitur provat të cilave u janë referuar dhe kanë mbështetur pretendimet e tyre.

Me 23 shkurt 2024, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktvendimin C-III-24-0019, e ka refuzuar si të pa bazuar propozimin e propozuesit të sigurimit Xh S B i paraqitur kundër kundërshtareve të sigurimit M T dhe K T, me të cilin ka kërkuar që t'u ndalohet kundërshtareve të sigurimit që të tjetërsojnë, fshehin, ngarkojnë ose të disponojnë me pasurinë e luajtshme si dhe të paluajtshme, deri në lartësinë e kërkesëpadisë. Në arsyetim të vendimit thuhet se pas shqyrtimit të propozimit dhe të gjitha të gjitha parashtrimeve të palëve në procedurë si dhe vlerësimit të provave të lëndës Gjykata ka ardhë në përfundim se propozimi për caktimin e masës së sigurimit nuk është i bazuar. Shkalla e I rë në arsyetim të vendimit ka theksuar se nga parashtrimet e palëve në procedurë dhe provat e prezantuara ka rezultuar se

:prona kontestuese (Parcela Kadastrale nr...), në të kaluarën ishte e evidentuar në operatin kadastral si pronë Shoqërore dhe pronare e saj ishte Ndërmarrja Shoqërore "Bujqësia", me seli në Fushë Kosovë. NSH-ja e konsideronte pronën si pronë shoqërore në pronësinë e saj dhe e kishte dhënë me qira afatgjate prej 10 vitesh, për kundërshtaret e sigurimit. Nga ana tjetër, Zyra Kadastrale Komunale në Prishtinë në vitet 2008-2010 kishte regjistruar pronën kontestuese në emër të një pale të tretë të quajtur M M, në bazë të një aktgjykimit të prezantuar me shenjën C.nr.395/96, të cilin më vonë pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, ishte kualifikuar përmes aktgjykimit si një "dokument i rrejshëm". Shkalla e I rë e Dhomës së Posaçme ka vërejtur se në këtë fazë të procedurës kemi dokumente të dyfishta, ku kundërshtaret e sigurimit dhe AKP-ja si ndërhyrës, me provat që kanë prezantuar në procedurë mbrojnë qëndrimin se prona kontestuese është pronë shoqërore me shumë investime të bëra nga kundërshtaret e sigurimit, e nga ana tjetër propozuesi i sigurimit duke iu referuar aktgjykimit të lartë përmendur, kontratës së shitblerjes dhe Certifikatës pronësore mbron qëndrimin se e gëzon të drejtën e pronësisë mbi pronën kontestuese. Shkalla e I rë në Aktvendimin e saj thekson se, Certifikata Pronësore prezanton të dhënat se propozuesi i sigurimit dhe disa subjekteve tjera janë në "bashkë posedim" të pronës kontestuese, dhe nuk i referohet termit "bashkë pronar". Rrjedhimisht, ka ardhur në përfundim se nuk është plotësuar kushti i parë për caktimin e masës së sigurimit nga se propozuesi i sigurimit, me provat e dorëzuar nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij. Po ashtu ka vlerësuar se çështja juridike në këtë rast është komplekse për shkak të dokumentacionit të dyfishtë dhe se rasti mund të analizohet dhe të shqyrtohet në detaje vetëm gjatë procedurës së rregullt që pritet të zhvillohet pranë dhomës së Posaçme.

Shkalla e I-rë ka konstatuar se paditësi nuk e ka vërtetuar me asnjë provë as rrethanën se do të ketë dëm të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm për palën paditëse, nëse nuk caktohet masa e sigurimit. Masa e sigurimit sipas Shkallës së I-rë i referohet përgjithësisht pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme deri në lartësinë e kërkesëpadisë, por në fakt, me petitumin e padisë (kërkesëpadinë) nuk është përcaktuar ndonjë vlerë. Edhe me parashtresën e rregullimit të padisë të datës 17 qershor 2022 propozuesi nuk ka përcaktuar ndonjë vlerë konkrete. Rrjedhimisht, propozuesi i sigurimit nuk ka arritur që të provojë se për cilën pasuri

konkretisht është fjala dhe po ashtu nuk ka arritur të provojë ndonjë ndërlidhje të saj pasurie me dëmin e pariparueshëm. Pra, kolegji vlerëson se nuk është përmbush kriteri ligjor se dëmi është i pariparueshëm, respektivisht nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartcekura, gjykata ka ardhur në përfundim se nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 61 i Ligjit për Dhomën e Posaçme, për caktimin e masës së sigurimit, e për të cilat arsye edhe u vendos si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

Me 06 mars 2024, paditësi propozuesi i masës së sigurimit nëpërmjet përfaqësuesit të tij ka paraqitur ankesë pranë Kolegjit të Apelit, për shkak të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Paditësi propozuesi i masës së sigurimit ka propozuar që të aprovohet në tersi si e bazuar ankesa e paditësit –propozuesit Xh S B, të anulohet Aktvendimi me numër të lëndës:2022:112205 të datës 23.02.2024, dhe rasti të kthehet për procedime të mëtutjeshme në kuptim të dispozitave ligjore. Ose alternativisht të aprovohet në tersi si e bazuar ankesa e paditësit-propozuesit Xh S B ose të ndryshohet aktvendimi me numër të lëndës:2022:112205 të datës 23 mars 2024, ashtu që të aprovohet si i bazuar propozimi për caktimin e Masës së Sigurimit.

Propozuesi i masës së sigurimit në ankesën e parashtruar nëpërmjet përfaqësuesit ka konsideruar se Aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave ligjore, për faktin se gjykata nuk ka arritur që ta arsyetoi dispozitivin e aktvendimit. Arsyet e dhëna në arsyetimin e aktvendimit janë kontradiktore me dispozitivin e aktvendimit, për faktin se gjykata nuk ka arritur të tregoi arsyet mbi refuzimin e propozimit me asnjë provë bindëse si dhe të arsyetojë dispozitivin e Aktvendimit , për faktin se gjykata nuk ka rritur të tregoi arsyet mbi refuzimin e propozimit me asnjë provë bindëse si dhe të arsyetojë diapozitivin e aktvendimit, sa i përket pjesës refuzuese nuk është dhëne as në arsye se mbi cilën bazë gjykata e ka refuzuar propozimin e paditësit-propozuesit, andaj konstatimet e gjykatës janë të pa mbështetura në fakte dhe prova, ashtu që aktvendimi është i përfshirë në shkelje ligjore dhe si i tillë nuk është i drejtë.

Propozuesi i masës së sigurimit në ankesë konsidero se Gjykata është e obliguar që në mënyrë të ndërgjegjshme t'i analizojë faktet e çështjes gjyqësore si dhe provat materiale dhe personale, në rastin lëndor gjykata në kundërshtim me institutet procedurale ka vepruar në rastin lëndor konstatimet e nxjerra janë të pa mbështetura në gjendjen e provave materiale dhe faktet e çështjes lëndore, rrjedhimisht figura e një gjykimi të drejtë është humbur në rastin lëndor rrethanë faktike e cila e bënë të paqëndrueshme juridikisht vendimin e atakuar. Në arsyetim të aktvendimit nuk është e qartë se cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar gjykata kur ka ardh në konstatime apo qëndrime juridike se propozimi është jo themeltar.

Po ashtu mocioni procedural në kuptim të legalitetit të vendimmarrjes të ecurisë procedurale parashtrohet mbështetur në faktin se gjykata vendimmarrëse nuk është e kompetencës lëndore për marrjen në shqyrtim të çështjes lëndore sipas objektit të saj. Gjykata i ka poseduar në cilësi të provës materiale historiatët e datës 06 nëntor 2020 nga të cilat vërtetohet fakti se palujatshmeria lëndore ishte në pronësi të NSH. Ndërmarrja Bujqësore "D e N" e më pastaj si rezultat i procese apo bazave juridike ka kaluar në pronar privat, për më shumë shihet thotë shih (historiatët e datës 06 nëntor 2020 si dhe certifikatën mbi të drejtat pronësore). Ankuesi, propozuesi i masës së sigurimit konsideron se gjykata nuk i ka çmuar me kujdes provat e propozuar kur ka konstatuar si në dispozitiv të aktvendimit, rrjedhimisht edhe institutet procedurale për faktin se dispozitat ligjore nga Ligji mbi Dhomat e Posaçme lidhur me AKP-në, ashtu siç përcaktojnë.

Ankuesi, propozuesi i masës së sigurimit po ashtu e ka kundërshtuar Juridiksion e kësaj gjykate sa i përket çështjes për vendosje pasi që sipas tij palujatshmeria lëndore asnjëherë nuk ka qenë nën Autoritetin e AKM-së, e po ashtu të AKP-së, për këtë provojnë provat materiale të gjendura në shkresat e lendes ashtu që gjykata është dashur të vlerësoje kompetencën në pikëpamje lëndore sa i përket objektit lëndor e në varësi të vërtetimit në mënyrë të drejtë dhe të plotë të faktit të larte cituar të vendos për ecurinë procedurale e në kuptim ligjor të hapet konflikti mbi kompetencën duke u bazuar edhe në nenin 6 të ligjit të përcaktuar.

Nisur nga rrethanat faktike e drejta subjektive e propozuesit është jo kontestuese sepse në shkresat e lëndës gjinden provat materiale që vërtetojnë se paditësi-propozuesi është pronar i paluajtshmerisë, ndera konstatimet e gjykatës janë periodikuese e praktikisht jo ligjore sepse gjykata nuk mund t'i parashikojë se çka do të ndodhë në të ardhmen, është gjykata e faktit dhe si e tillë obligohet të mbështetet në fakte dhe prova materiale, e në rastin lëndor kemi të bëjmë me vendim të pa arsyetuar, kontradiktor dhe në kundërshtim me dispozitat procedurale, në kuptim të nenit 61.

Ankuesi, propozuesi i masës së sigurimit po ashtu e ka kundërshtuar konstatimin e shkallës së I-rë për refuzimin e caktimit të masës së sigurimit, pasi që sipas ankuesit/propozuesit të masës së sigurimit nuk është i bazuar, në bazë të Ligjit për Dhomën e Posaçme, përkatësisht neni 61 gjendja e fakteve dhe provave materiale nuk ka provuar se në kundërshtim me dispozitat ligjore të përcaktuara ka vendosur gjykata për faktin se janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurisë. Në kuptim të fakteve ekzistimi i kërkesës është i besuar po ashtu edhe rreziku real, tersi e veprimeve nga kundër propozuesit që të vështirësojnë dukshëm të drejtën subjektive të propozuesit, në mënyrë të qartë është cenuar dispozita ligjore e lartë cituar.

Po ashtu ankuesi/propozuesi i masës së sigurisë e ka kundërshtuar konstatimin e shkallës së I-rë pasi që konsideron si është vërtetuar në mënyrë të gabuar në kuptim të faktit se propozuesi nga provat materiale Certifikata mbi të drejtat Pronësore, e pasuar me Historiatin mbi Origjinën e Pronësisë është vërtetuar se është pronar i paligjshmerisë.

Ankuesi/propozuesi i masës së sigurimit e kundërshton konstatimin e shkallës së I-rë në arsyetim të Aktvendimit e cila ka konstatuar në arsyetim të Aktvendimit se nga parashtrimet e palëve në procedurë dhe provat e prezantuar ka realizuar se: Prona kontestuese (Parcela Kadastarle nr...), në të kaluarën ishte e evidentuar në operatin kadastral si pronarë shoqëror dhe pronare e saj ishte Ndërmarrja Shoqërore "Bujqësia" me seli në Fushë Kosovë. Ankuesi e kundërshton këtë konstatim pasi që konsideron se është tërësisht i gabuar dhe e vërteton pretendimin e përfitimeve të kundërligjshme të kundërpropozuesve, këtë konstatim e rrëzojnë

provat materiale historiatin mbi palujatshmerinë lëndore në të cilën nuk evidentohet asnjëherë se KBI "Bujqësia" ka qenë pronare e paligjshmërisë lëndore në të cilin nuk evidentohet asnjëherë se KBI "Bujqësia" ka qenë pronare e paluajtshmerisë lëndore, andaj është konstatim i gabuar jashtë rrethanave kontekstuale dhe përmbajtjes së provave materiale.

Ankuesi/propozuesi i masës së sigurisë e kundërshton konstatimin e shkallës së I-rë e në arsyetim të Aktvendimit të atakuar cila ka konstatuar se Kolegji i Dhomës së Posaçme vëren se në këtë fazë të procedurës kemi dokumente të dyfishta ku kundërshtaret e sigurimit dhe AKP si ndërhyrës, me provat që kanë prezantuar në procedurë mbrojnë qëndrimin se prona kontestuese është pronë shoqërore me shumë investime të bëra nga kundërshtaret e sigurimit. Ankuesi e kundërshton këtë konstatim pasi që ky konstatim është i gabuar, se AKP-ja mund të pretendojë, por pretendimet duhet të mbështeten në fakte dhe prova materiale, elauburanti kadastral i pasqyruar në historiatin mbi origjinën e paluajtshmerisë të datës 06 nëntor 2020, vërteton se ky pretendim është i pa mbështetur po ashtu certifikata mbi të drejtat pronësore. Në rastin lëndor nuk bëhet fare fjalë për dokumente të dyfishta sepse asnjëra nga palët kundërshtaret nuk ka prezantuar asnjë provë që vërteton se e ka fituar pronësinë sipas ndonjë baze juridike, konstatimi i gjykatës është jashtë rrethanav kontestuale dhe kërkesës kryesore.

Ankuesi/propozuesi i masës së sigurisë konsideron se konstatimet e gjykatës janë të mbështetura në prova, referenca e gjykatës si në pikën A) është në kundërshtime njohuritë e përgjithshme pos tjerash më mirë se askush tjetër gjykata e ka të njohur faktin se kur është themeluar AKM-ja, nga themelimi i kësaj të fundit ka pushuar çdo administrim i mëvetësishëm i NSH, ndërsa gjykata jep referencë kontratën afatgjate të pretenduar. Ky është miratim në kundërshtim me parimin e disponibilitetit, ajo kontratë është e falsifikuar e keqpërdorur nga njerëzit që e mbajnë pronën pa bazë juridike dhe gjykata i arsyeton një anshërisht sikur të ishte avokat i palës kundërshtarë, a do duhej të vlerësonte gjykata legalitetin e asaj kontrate, a do duhej gjykata të vlerësonte renovimin e asaj kontrate pas skadimit të saj, si është e mundur që dikush në Prishtinë të mbajë pronë pa bazë juridike, Kolegji i shkallës së I-rë me vendosjen si në vendim të atakuar ka shpërfaqur pasiguri juridike edhe cenim të gjykimit të drejtë dhe të pa anshëm.

Po ashtu ankuesi/propozuesi i masës së sigurisë konsideron se Shkalla e I-rë me aktvendimin e ankimuar ka anashkaluar në tersi dispozitat e së drejtës materiale dhe parimet e drejtësisë që lidhen me çështjen për të cilën është propozuar masa e sigurisë. Kërkesa kryesore në çështjen lëndore, kërkesëpadia e paditësit rezulton më besueshmëri në të drejtën materiale, në kuptim të faktit se parashtrohet nga pronari i paluajtshmerisë lëndore, ashtu që mbrojtja e pronësisë si e drejtë subjektive e propozuesit është cenuar nga ana e gjykatës.

Më 22 mars 2024, AKP-ja në cilësinë e ndërhyrësit ka parashtuar përgjigje ndaj ankesës e cila në tersi e kundërshton ankesën e të paditurës të parashtuar kundër Aktvendimit C-III-24-0019 të datës 23 shkurt 2024, duke e konsideruar si të pa bazuar në ligj. AKP-ja ka theksua se qëndron pranë të gjitha thënieve dhe provave të paraqitura në Gjykatë. Po ashtu AKP-ja konsideron se paditësi/ankuesi as me ankesën e paraqitur kundër aktvendimit, nuk kanë arrit të paraqesin ndonjë bazë juridike të besueshme, dhe as nuk ka mundur të konstatojnë një gjendje tjetër faktike prej asaj siç e ka vërtetuar Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme. Në përfundim AKP-ja konsideron se pretendimet e paraqitura ne ankesë nuk janë të mbështetura me dëshmi dhe fakte materiale që do të ishin relevante për rastin konkret. Mungesat e tilla, ankesën e bëjnë të paqëndrueshme.

Përfaqësuesi i Kundër propozuesve e ka pranuar urdhrin e Gjykatës me dt. 15 mars 2024 për të dhen përgjigje në ankese, mirëpo nuk ka paraqitur ndonjë përgjigje.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kriteret se kur duhet të lëshohet Masa e Sigurisë përcaktohen në nenin 61.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme: Pala duhet të ofrojë dëshmi të besueshme se do të rezultojë me humbje dhe dëmtim të drejtpërdrejtë dhe të pariparueshëm nëse nuk miratohet kërkesa. Këto kritere janë përcaktuar në atë mënyrë që nëse ndonjëra nga të mësipërmet mungon, kërkesa do të refuzohet.

Kërkesa për dëshmi të besueshme duhet ti përmban që të dyja: *fumus boni iuris* (probabiliteti se ekziston e drejta e kërkuar pre supozimi i bazës së mjaftueshme ligjore), dhe *periculum in mora* (rreziku i dëmtimit i pashmangshëm dhe i pariparueshëm ndaj kësaj të drejte), pasi që humbja dhe dëmtimi i drejtpërdrejtë dhe i pariparueshëm mund të ndodhë vetëm nëse ekziston në të vërtetë e drejta e pretenduar (shih jurisprudencën e përhershme të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së: cf., inter alia, ASC-10-0079, ASC-10-0081, ASC-10-0017, ASC-10-0049, ASC-10-0088).

Me fjalë të tjera: Paditësi/Ankuesi e cila kërkon Masë të Sigurisë duhet të dëshmoj probabilitetin se 1) ekziston rreziku i të drejtës të cilën e kërkon, dhe 2) e drejta është në rrezik të drejtpërdrejtë të humbjes ose dëmtimit të pariparueshëm, nëse nuk lëshohet Masa e Sigurisë e cila kërkohet.

Në këtë lëndë, Kolegji i Apelit vëren se paditësi me dt. 01 qershor 2022, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka paraqitur padi për kompensim dëmi, kundër të paditurve M dhe K T, me propozim për masë sigurimi. Në padi dhe propozimi për masë sigurimi, ndër të tjera ka theksuar sa ai është bashkëpronar i paluajtshmerisë-Parcelë Kadastrale, P-..., që gjendet në Zonën Kadastrale Prishtinë, vendi i quajtur J. Sipas paditësit të paditurit kanë qenë në posedim të pronës kontestuese që nga koha kur paditësi e ka fituar të drejtën e tij pronësore. Paditësi me padi ka propozuar që gjykata të marrë aktgjykim me të cilin do të detyrojë të paditurin që t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar, në lartësinë që do të përcaktohet përmes ekspertizës.

Me 10 shkurt 2023 Gjykata themelore në Prishtinë, me Aktvendimin C.nr.2646/22, AKP-së i ka pranuar cilësia e ndërhyrësit në procedurë, në anën e të paditurve,

është shpallur jo kompetente për gjykimin në këtë çështje kontestimore dhe lëndën e ka dërguar në kompetencë të mëtejshëm në Dhomën e Posaçme. Kundër këtij aktvendimi paditësi kishte parashtruar ankesë ne Gjykatën e Apelit. Me 28 shtator 2023 Gjykata e Apelit me Aktvendimin Ac.nr.2587/23, e kishte refuzuara ankesën e paditësit si të pabazuar dhe kishte vërtetuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore C.nr.2646/22.

Me 23 shkurt 2024, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktvendimin C-III-24-0019, e ka refuzuar si të pa bazuar propozimin e propozuesit të sigurimit Xh S B i paraqitur kundër kundërshtareve të sigurimit M T dhe K T, me të cilin ka kërkuar që t'u ndalohet kundërshtareve të sigurimit që të tjetërsojnë, fshehin, ngarkojnë ose të disponojnë me pasurinë e luajtshme si dhe të paluajtshme, deri në lartësinë e kërkesëpadiisë.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi i me padi ka propozuar që gjykata të marrë aktgjykim me të cilin do të detyrojë të paditurit që t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar, në lartësinë që do të përcaktohet përmes ekspertizës. Me datën 06 dhjetor 2024, paditësi ka bërë korrigjimin e padisë, ku ka kërkuar që të detyrohen të paditurit që t'ia dorëzojnë në posedim paluajtshmerinë – NK..., si dhe t'ia kompensojnë dëmin e shkaktuar për shkak të shfrytëzimit të pa autorizuar të saj. Po ashtu ka kërkuar që t'u ndalohet kundërshtareve të sigurimit që të tjetërsojnë, fshehin, ngarkojnë ose të disponojnë me pasurinë e luajtshme si dhe të paluajtshme, deri në lartësinë e kërkesëpadiisë.

Kolegji i Apelit ndryshe nga Kolegji i shkallës së parë vlerëson se paditësi me provën e dozuara siç është Certifikata e dt. .. mars .., e cila përmban të dhënat për nejësin kadstarle shihet se parcela kontestuese ...e evidentohet në emër të paditësit dhe disa bashkposeduesve të tjerë, prandaj mund të themi se në këtë fazë të procedurës e ka bërë të besueshëm faktin e ekzistimit e kërkesës apo të së drejtës subjektive, por kushti tjetër siç ka konstatuar edhe Shkalla e I-rë rreziku për dëm të menjëhershëm nuk është plotësuar.

Edhe Kolegji i Apelit vlerëson se paditësi nuk e ka paraqitur ndonjë rrethanë, nga e cila pritet të pësojë ndonjë dëm të menjëhershëm dhe te pariparueshëm, meqë sipas kërkesave ligjore përveç që duhet të bëhet e besueshme e drejta e pretenduar, duhet që paditësi të dorëzojë dëshmi të besueshme se kjo e drejtë mund të dëmtohet menjëherë dhe në mënyrë të pariparueshme, nëse nuk miratohet kërkesa për masë të sigurimit.

Kolegji i Apelit verën se paditësi me ankesën e tij të paraqitur kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë, me të drejtë ka ngritur disa çështje të cilat i kishte theksuar Shkalla e I-rë në që edhe sipas vlerësimit të Kolegjit të Apelit kanë të bëjnë më çështjen e meritave e të cilat duhet vlerësuar në fazën e mëvonshme kur të vendoset për çështjen kryesore. Kolegji i Apelit vlerëson se Shkalla e I-rë, është dashur më tepër të fokusohet tek plotësimi i kriterëve të kërkesë për caktimin e masë së sigurimit e jo tek pretendimet e palëve. Megjithatë këto konstatime nuk mund të ndikojnë që Aktvendimi i kundërshtuara të ndryshohet apo të mos jetë saktë në rezultat.

Kolegji i Apelit në këtë fazë të procedurës përmbahet nga vlerësimi dhe konstatimi i provave të cilat gjenden e në shkresat e lëndës, ngase objekt i vlerësimit në këtë fazë është kërkesa e paditësit për caktimin masës së sigurimit nëse i plotëson apo jo kushte për caktimin e masës së sigurimit e jo çështja meritore.

Tutje Kolegji i Apelit verën se paditësi në procedurë të Shkallës së II-të e konteston edhe Juridiksionin e DHPGJS. Kolegji i Apelit vlerëson se është i pathemeltë pretendimi i paditësit i paraqitur në këtë fazë të procedurës pasi që paditësi në lidhje me kompetencën për vendosje të kësaj çështje juridike i ka shterur mjete juridike tek gjykata e rregullta. Aq më tepër kur në cilësinë e ndërhyrësit kemi të përfshirë edhe AKP, e cila pretendon se prona kontestuese është e NSH-së. Prandaj në këtë fazë të procedurës kur kemi të bëjmë me shqyrtimin e kërkesës për caktimin e masës së sigurimit e cila është e natyrës urgjente Kolegji i Apelit do fokusohet më tepër tek kjo kërkesë dhe se vlerëson se nuk është pengës për vendosjen kësaj çështje meqë nuk është çështje meritore. Kolegji i Apelit i sygjeron Shkallën e I-rë që në çdo fazë varësisht nga provat të cilat prezantohen në procedurën me shkrim ta shikoj çështjen e Juridiksionit.

Kolegji i Apelit vlerëson se në këtë fazë të procedurës pavarësisht se paditësi ka sjellë provë certifikatën e lartcekur për ekzistimin e kërkesës së tij, prapë nuk mund të caktohet masa e sigurimit pa u plotësuar edhe kushti tjetër propozuesi nuk ka ofruara prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit.

Në rastin konkret, Kolegji i Apelit vlerëson se pa paragjykuar rrezikun në të ardhmen dhe themelësinë e kërkesës kryesore, një rrezik i tillë për tu tjetërsuar prona nuk ekziston, meqë siç kemi theksuar me lartë parcela kontestuese ... e evidentohet në emër të paditësit dhe disa bashkposeduesve të tjerë dhe nuk ka rrezik që pala kundërshtarë apo AKP mund të ndër marrë ndonjë veprim me qëllim të tjetërsimit apo ngarkimit të saj.

Përderisa paditësi nuk kanë ofruar dëshmi të besueshme se ekziston rreziku për dëm të menjëhershëm, kërkesa e paditësit për Masë caktimin e masë së sigurimit nuk ka mbështetje në dispozitën e nenit 61 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Andaj për këto arsye, Kolegji i Apelit e refuzon ankesën e paditësit/ankuesit si të pa bazuar dhe e vërteton Aktvendimin e ankimuar si të drejtë dhe të bazuar në Ligj.

Ky aktvendim nuk prejjudikon zgjidhjen përfundimtare në meritat e padisë.

Prandaj nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 18 mars 2024, në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendosë nga Kolegji i Apelit me 18 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues _____